

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e RTSH-së në drejtim të përmbushjes së misionit të saj, realizimit të shërbimeve cilësore të radios dhe televizionit për të informuar, edukuar dhe argëtuar publikun, duke i shërbyer kombit, të gjitha grupeve të shoqërisë, përfshirë edhe pakicave kombëtare;

Duke njohur përpjekjet e RTSH-së për realizimin e programeve cilësore, ofrimin e një game të gjerë projektesh në interes të grupeve të ndryshme sociale, rritjen e audiencës dhe shtrirjen sa më të madhe në vend;

Duke konsideruar se veprimtaria e RTSH-së është kryer në përputhje të plotë me detyrimin për të pasur nga ana e saj një mbulim të paanshëm dhe të balancuar të lajmeve të vendit dhe atyre ndërkombëtare, duke bërë të mundur rritjen e besimit të publikut;

Vlerëson veprimtarinë e Radiotelevizionit Shqiptar gjatë vitit 2024 në drejtim të:

Transmetimit në strukturën programore të RTSH-së, me 16 kanale televizive dhe 11 radiofonike duke mbuluar mbi 95% të territorit dhe rreth 80% të popullsisë, të një programacioni të larmishëm, me qëllim plotësimin e misionit informues, edukues dhe argëtues.

Forcimit të diversitetit kulturor përmes transmetimit të përmbajtjeve programore në 8 gjuhë minoritare, duke garantuar përfshirje të barabartë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet.

Transmetimit të disa prej ngjarjeve kryesore sportive ndërkombëtare dhe vendase dhe rritjes së audiencës përmes transmetimit të Kampionatit Shqiptar të Futbollit.

Vijimit të procesit të digjitalizimit të arkivit të institucionit me qëllim ruajtjen dhe aksesin e sigurt të materialeve audiovizive, si dhe modernizimin e pasurisë arkivore.

Kuvendi kërkon që Radiotelevizioni Shqiptar, për vitin 2025, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të angazhohet në hartimin dhe miratimin e një plani strategjik për rimodelimin e transmetuesit publik, me qëllim ristrukturimin organizativ e strukturor, ristrukturimin buxhetor (fokusim të fondeve nga pagat drejt investimeve në përmbajtje dhe teknologji), përmirësimin e përmbajtjeve programore, si dhe zhvillimin e teknologjive digjitale, në përputhje me standardet bashkëkohore.

2. “RTSH Kuvend”, përmes angazhimit të stafit redaksional, të përfshijë në programacion përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave apo analizave profesionale me ekspertë të fushës për projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin, në funksion të konsultimit publik për aktet ligjore.

3. Të realizojë një audit të plotë, me qëllim vlerësimin e situatës financiare aktuale të institucionit, analizimin e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike, si dhe t’ia përcjellë raportin analitik Kuvendit të Shqipërisë.

4. Të intensifikojë procesin e digjitalizimit të arkivit të institucionit.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 30.10.2025.